



Rregullorja e brendshme

Burgjet rajonale të kantonit të Bernë



Bernë, me 22 shkurt 2019

Përmbajtja

1	Të përgjithshme	4
1.1	Baza ligjore	4
1.2	Fusha e aplikimit	4
1.3	Organizimi	4
1.4	Drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.....	4
1.5	Drejtoresha / Drejtori	5
1.6	Punonjësit	5
1.7	Situatat e jashtëzakonshme.....	5
2	Detyrat.....	5
3	Statusi juridik i personave të burgosur	6
3.1	Të drejtat e personave të burgosur	6
3.2	Detyrimet e personave të burgosur	6
3.3	Sigurimet kundrejt aksidenteve	6
4	Hyrja.....	6
4.1	Baza ligjore	6
4.2	Efektet personale dhe vlerat pasurore të personit të burgosur	6
4.3	Orientimi i familjarëve dhe përfaqësuesve ligjor mbi burgosjen dhe transferimin.....	7
5	Udhëheqja e llogarisë	7
6	Shpenzimet personale	8
7	Shkallët e ekzekutimit të vendimeve.....	8
7.1	Përcaktime të përgjithshme	8
7.2	Përcaktime të veçanta në arrestin hetimor dhe të sigurisë.....	8
8	Rutina ditore, strehimi, ushqimi, higjiena trupore.....	9
8.1	Rutina ditore.....	9
8.2	Strehimi.....	9
8.3	Shëtitja.....	9
8.4	Ushqimi dhe kioska	9
8.5	Larja e rrobave dhe higjiena trupore.....	10
8.6	Pirja e duhanit	10
8.7	Kafshët.....	10
9	Mundësitë e kontaktit	10
9.1	Vizitat.....	10
9.2	Posta me letër	11
9.3	Pakot, dhuratat, paratë e gatshme	11
9.4	Gazeta, revista, libra.....	12
9.5	Mjetet dhe pajisjet e komunikimit elektronik.....	12
9.6	Telefonia	12
10	Kujdesi social dhe mjekësor	13
10.1	Kujdesi social	13
10.2	Kujdesi mjekësor	13
11	Kujdesi shpirtëror dhe kujdesi tjetër fetar	13
11.1	Kujdesi fetar	13
11.2	Kujdesi tjetër fetar	13
12	Puna	14
12.1	Puna	14
12.2	Shpërblimi i punës.....	14
13	Kontrollet dhe ekzaminimet.....	15
13.1	Kontrolli fizik.....	15
13.2	Kontrollet dhe marrja e kampioneve.....	15
13.3	Kontrolli i qelive dhe i pasurive të lëvizshme	15
13.4	Të rinjtë.....	15

14	Masat disiplinore	15
14.1	Shkeljet disiplinore	15
14.2	Veprimet disiplinore	16
15	Masa të veçanta sigurie	17
15.2	Urdhër	18
15.3	Mjetet ligjore	18
16	Dalja dhe lirimi	19
16.1	Dalja	19
16.2	Lirimi	19
17	Përgjegjësia	19
18	Dispozita përfundimtare	19
18.1	Rregulla plotësuese	19
18.2	Hyrja në fuqi	19
Shtojcë		20

1 Të përgjithshme

1.1 Baza ligjore

Rregullorja e brendshme në fjalë mbështetet në kodin penal zviceran i datës 21 dhjetor 1937 (StGB, SR 311.0), ligjin federal të datës 20 qershor 2003 mbi të drejtën penale për të rinjtë (JStG; SR 311.1), kodin e procedurës penale zvicerane të datës 5 tetor 2007 (StPO, SR 312.0), kodin e procedurës penale zvicerane për të rinjtë e datës 20 mars 2009 (JStPO, SR 312.1), në ligjin e datës 23 janar 2018 për ekzekutimin e vendimeve penale (JVG; BSG 341.1), rregulloren e datës 22 gusht 2018 mbi ekzekutimin e vendimeve penale (JVv; BSG 341.11), në ligjin e datës 16 qershor 2011 mbi masat kufizuese të lirës në ekzekutimin e vendimeve penale për të rinjtë dhe në ekzekutimin e masave për mbrojtjen e fëmijëve (FMJG; BSG 341.3), ligjin penal ushtarak të datës 13 qershor 1927 (MStG; SR 321), kodin e procedurës penale ushtarake të datës 23 mars 1979 (MStP; SR 322.1), ligjin për policinë të datës 8 qershor 1997 (PolG; BSG 551.1), kodin civil zviceran të datës 10 dhjetor 1907 (ZGB; SR 210).

Bazat përkatëse ligjore mund të merren në formatin e printuar pranë drejtuesve të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

Në rastin e të rinjve që janë dërguar këtu merren parasysh detyrimet e mbrojtjes së të rinjve.

1.2 Fusha e aplikimit

Kantoni i Bernë disponon burgjet rajonale Bernë, Biel, Burgdorf, Moutier dhe Thun.

Rregullorja e brendshme vlen për të gjitha burgjet rajonale të kantonit të Bernë si dhe për të gjitha llojet e arrestimeve që ekzekutohen në këtë institucione. Organi monitorues në Inselspital Bernë (BEWA) disponon një rregullore të brendshme të veten.

Për departamentin e ekzekutimit të vendimeve Burgdorf (VAB) vlejné gjithashtu përcaktime plotësuese kundrejt rregullores së brendshme e burgjeve rajonale të kantonit të Bernë.

Kryerja dhe organizimi i arrestit të ekstradimit me qëllimin e hetimit të veprës penale bazohet te përcaktimet për arrestin hetimor dhe të sigurisë. Arresti i ekstradimit me qëllimin e ekzekutimit të një sanksioni penal kryhet në përputhje me përcaktimet e përgjithshme për dënimet me heqje lirie dhe masat ligjore penale për heqjen e lirisë.

1.3 Organizimi

Kantoni i Bernë, për burgjet rajonale është i ndarë në rajonet Bernë Mittelland, Biel-Seeland-Berner Jura, Emmental Oberaargau dhe Berner Oberland.

Burgjet rajonale të kantonit të Bernë janë në varësi të Autoritetit të ekzekutimit të vendimeve penale (AJV) të drejtorisë së policisë dhe ushtrisë të kantonit të Bernë (POM). Drejtoria e çdo burgu rajonal mban të gjithë përgjegjësinë kundrejt qendrës eprore të AJV.

Drejtoritë e burgjeve rajonale, me miratimin e drejtoreshës ose të drejtorit të AJV, mund të përdorin borde këshilluese në varësi të situatës ose në mënyrë të përhershme.

POM është autoriteti monitorues mbi burgjet rajonale të kantonit të Bernë.

Drejtuesit e prokurorisë përgjegjëse vendore monitorojnë ekzekutimin e arrestit hetimor ose të sigurisë në burgun rajonal të rajonit që i është caktuar asaj. Ajo inspekton një herë në vit burgun përkatës rajonal. Ajo ja raporton mangësitë e përcaktuara prokurorisë së përgjithshme dhe informon drejtorinë për institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Drejtoria e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale organizon eliminimin e mangësive. Më tej vlejné e drejta e monitorimit dhe detyrimi i monitorimit i AJV dhe i POM.

1.4 Drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale

Te drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale përfshihen niveli i parë dhe i dytë i udhëheqjes. Niveli i parë i udhëheqjes është drejtoria e burgut rajonal, ajo përbëhet nga drejtoresha / drejtori dhe zëvendës drejtoresha / zëvendës drejtori. Në nivelin e dytë të udhëheqjes përfshihen personat

e përcaktuar nga drejtoresha / drejtori, normalisht drejtuesit e sektorëve (shihni organigramën e institucionit përkatës).

1.5 Drejtoresha / Drejtori

Drejtoresha / Drejtori kryen detyrat e mëposhtme:

- a. Mbajtjen e të gjithë përgjegjësisë
- b. Sigurimin e operimit në përputhje me të drejtat themelore
- c. Rregullimin e përgjegjësive të brendshme dhe lëshimin e përcaktimeve të brendshme
- d. Përfaqësimin e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale nga jashtë

Në rastin e mungesës së drejtoreshës / drejtorit përgjegjësia i mbetet zëvendësit të tij / saj.

1.6 Punonjësit

Punonjësit veprojnë bazuar në direktiva dhe parime udhëheqje etike.

Ato nuk lejohen që të kryejnë marrëveshje ligjore me personat e burgosur, përkatësisht nuk lejohen që të kryejnë ose të marrin asnjë punë ose shërbim për qëllime private.

1.7 Situatat e jashtëzakonshme

Në situata të jashtëzakonshme – përkatësisht zjarr, ngjarje elementare, rebelim, arratisje, sulme nga jashtë, kryengritje, marrje peng ose emergjenca mjekësore – drejtoria e burgut rajonal, me miratim të qendrës eprorë të autoritetit të ekzekutimit të vendimeve penale mund të marrë masa që nuk përputhen me rregulloren e brendshme.

Në raste urgjente miratimi i qendrës eprorë të AJV mund të merret më vonë.

2 Detyrat

Në përputhje me nenin 9 pika 1 Bst. a deri k dhe pika 2 Bst. a deri d të ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale për të rinjtë, burgjet rajonale i shërbejnë ekzekutimit të

- arrestit hetimor dhe të sigurisë të të rriturit dhe të rinjtë,
- dënimeve të shkurtra me heqje lirie deri në 30 ditë të të rriturit dhe të rinjtë,
- heqjeve të lirisë në formën e burgimit të përgjysmuar të të rriturit dhe të rinjtë,
- arrestimin e ekstradimit të të rriturit dhe të rinjtë,
- masat mbrojtëse të drejtësisë penale për heqjen e lirës dhe heqjen e lirisë në rastin e të rinjve në formën e arrestit dhe të arrestit të sigurisë,
- paraburgim në përputhje me kodin e procedurës penale dhe kodin ushtarak të procedurës penale të të rriturit dhe të rinjtë,
- ndalimin policor dhe ndalimin e sigurisë sipas ligjit për policinë të të rriturit dhe të rinjtë,
- Arrest gjatë transporteve të të rriturit dhe të rinjtë,
- masat detyruese për heqjen e lirisë të së drejtës së të huajve të të rriturit dhe të rinjtë,
- arrestin e jashtëzakonshëm në përputhje me kodin penal ushtarak.

Në raste të veçanta ato përdorën për ekzekutimin e:

- Dënimet me heqje lirie dhe masat penale për heqjen e lirisë të të rriturit, të cilët për arsye disiplinore, sigurie, vendi nuk mund të kryhen përkohësisht në një vend tjetër,
- arrest sigurie që ekzekutohet bazuar në ligj,
- masa mbrojtëse penale për heqjen e lirisë dhe heqjen e lirisë të të rinjtë sipas kodit penal për të rinjtë,
- strehimin në rast kujdes sipas kodit civil.

3 Statusi juridik i personave të burgosur

3.1 Të drejtat e personave të burgosur

Personat e burgosur posedojnë të drejtën e respektimit të personalitetit dhe të dinjitetit të tyre. Personat e burgosur posedojnë të drejtën që të dëgjohen për çështjet personale dhe të drejtën e propozimit në çështjet operative.

Personat e burgosur që posedojnë të drejtën e votimit dhe zgjedhjes, mund të sigurojnë në rrugë shkresore në rajonet ku ato janë regjistruar si banor dokumentet përkatëse dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre politike. Një pjesëmarrje në zgjedhjet e grumbulluara është e përjashtuar.

Të drejtat e tyre kushtetuese dhe ligjore lejohet të kufizohen deri në atë masë, sa e kërkon qëllimi i heqjes së lirisë dhe sa është e nevojshme për një bashkëjetesë të sigurt dhe të rregullt në burgun rajonal.

Personat e burgosur posedojnë të drejtën që çdo ditë të dalin të paktën për një orë në ajër të pastër.

3.2 Detyrimet e personave të burgosur

Personat e burgosur duhet të respektojnë rregulloret e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe duhet të zbatojnë urdhrat e drejtuesve të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe të personelit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale si dhe të autoritetit që i ka dërguar ato aty.

Personat e burgosur duhet që të mos kryejnë asnjë aktiviteti, që rrezikon zbatimin e rregullt të heqjes së lirisë dhe ruajtjen e sigurisë dhe rregullit.

3.3 Sigurimet kundrejt aksidenteve

Kantoni i Bernë nuk i siguron vetë personat e burgosur. Sigurimi kolektiv kundrejt aksidenteve i kantonit të Bernë aplikohet vetëm në mënyrë plotësuese.

4 Hyrja

4.1 Baza ligjore

Burgosja në një burg rajonal të kantonit të Bernë kryhet bazuar në urdhrin e burgosjes, një arsye arresti në përputhje me kodin e procedurës penale, kodin e procedurës penale për të rinjtë, kodin ushtarak të procedurës penale, ligjin për policinë ose një titull ligjor të qendrës përgjegjëse sipas të drejtës për të huajt.

4.2 Efektet personale dhe vlerat pasurore të personit të burgosur

4.2.1 Vlerat pasurore

Të gjitha paratë e gatshme i merren personit të burgosur dhe deri në një vlerë të përcaktuar nga drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale i kalohen llogarisë së lirë dhe sasi të mbetura llogarisë së qëllimshme.

Për vlerat pasurore të personave të burgosur, të cilët transferohen nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale vlejnë përcaktimet në përputhje me planin e ekzekutimit të vendimit të institucionit të mëparshëm.

4.2.2 Objektet

Për objektet e sjella me vete ose të dërguara më vonë (pasuritë e lëvizshme), dokumentet e identifikimit, sendet me vlerë dhe paratë e gatshme në monedhë të huaj përpilohet një inventar, plotësia dhe saktësia e të cilit konfirmohet me nënshkrim nga personi i burgosur. Personi i burgosur sa herë që është e mundur përfshihet në përpilimin e inventarit. Lista e pasurive të lëvizshme konfirmohet me nënshkrim të dyfishtë nga personi i burgosur dhe kujdestari përgjegjës. Nëse personi i burgosur nuk është i pranishëm,

konfirmimi kryhet me nënshkrimin e dyfishtë të kujdestarit përgjegjës dhe të një punonjësi tjetër të burgut rajonal.

Drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale përcaktojnë llojin, madhësinë dhe numrin (shihni shtojcën, fletët informuese për vizitat zyrtare dhe private) e objekteve të lejuara në burgun rajonal dhe vendosin, se cilat objekte mund të merren me vete në qeli. Drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale vendosin, nëse dhe cilat nga objektet që i janë marrë personit të burgosur do të ruhen në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale. Objektet e tjera, personi i burgosur me shpenzimet e tij mund ti magazinon, dërgojë ose ti përdorë jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Përndryshe këto objekte shkatërrohen. E rezervuar mbetet konfiskimi i objekteve në përputhje me nenin 263 të kodit të procedurës penale.

Për pasuritë e lëvizshme personale të marra me vete në qeli është përgjegjës vetë personi i burgosur. Për objektet e marra me vete në qeli, por që më pas kanë humbur, nuk gjenden më ose janë dëmtuar, burgjet rajonale, autoriteti i ekzekutimit të vendimeve penale dhe kantoni i Bernë nuk marrin asnjë përgjegjësi.

Marrja me vete e pajisjeve teknike në burgun rajonal është kryesisht e ndaluar (shihni shtojcën). Në raste të arsyetuara drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale mund të lejojnë përjashtime. Në rastin e personave të burgosur që gjenden në arrest hetimor dhe sigurie, nevojitet gjithashtu edhe miratimi i drejtuesve të procesit në përputhje me kodin e procedurës penale.

Për arsye të sigurisë, qetësisë dhe rregullit ose të shëndetit dhe higjienës, objektet mund ti merren në çdo moment personit të burgosur.

4.3 Orientimi i familjarëve dhe përfaqësuesve ligjor mbi burgosjen dhe transferimin

4.3.1 Të përgjithshme

Personat e burgosur posedojnë të drejtën që të orientojnë vetë ose nga të tjerët familjarët, të njohurit që ju qëndrojnë pranë dhe nëse është e nevojshme përfaqësuesit e tyre ligjor mbi dërgimin në një burg rajonal. Orientimi mund të kryhet përmes avokates / avokatit të tyre.

Në rastin e transferimit në një institucion tjetër për ekzekutimin e vendimeve penale, burgu rajonal përgjegjës deri më tani garanton që familjarët e përfshirë deri më tani dhe përfaqësuesi ligjor të informohen në mënyrën e duhur.

4.3.2 Përcaktime të veçanta në arrestin hetimor dhe të sigurisë

Informimi i familjarëve, i personave të njohur që i qëndrojnë pranë dhe nëse është e nevojshme i përfaqësuesit ligjor mbi dërgimin në arrestin hetimor dhe të sigurisë është përgjegjësi e drejtuesve të procesit.

Transferimi i personit të burgosur, i cili gjendet në arrest hetimor dhe sigurie në një burg tjetër rajonal, në një institucion tjetër për ekzekutimin e vendimeve penale, në stacionin e monitorimit në Inselspital Bernë (BEWA) ose në një institucion tjetër mjekësor kryhet duke përfshirë drejtuesit e procesit.

5 Udhëheqja e llogarisë

Për çdo person të burgosur nga ana e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale udhëhiqet një llogari e lirë dhe një e qëllimshme.

Llogaria e lirë shërben për mbulimin e shpenzimeve personale, sidomos për shpenzimet e nevojave ditore. Llogaria e qëllimshme shërben për mbulimin e shpenzimeve personale. Personat e burgosur nuk mund ta disponojnë sipas dëshirës llogarinë e qëllimshme. Drejtuesit e institucionit mund të lejojnë ngarkimin e llogarisë së qëllimshme gjatë vuajtjes së dënimit ose ta miratojnë atë me kërkesë të personit të burgosur.

6 Shpenzimet personale

Shpenzimet personale të personit të burgosur nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me institucionin. Personat e burgosur përballojnë shpenzimet personale.

Ato përfshijnë shpenzimet për qëndrimin dhe trajtimet mjekësore në një spital ose klinikë, trajtimet mjekësore ambulante, trajtimet mjekësore nga specialiste dhe specialistë të jashtëm, medikamente, mjete ndihmëse mjekësore, trajtimet te dentisti, tarifat e sigurimeve shëndetësore, tarifat dhe kontributet, kontributet AHV-/IV, pasuritë personale të lëvizshme, shërbimet dhe integrimin e shpenzimeve profesionale, shpenzimet për trajnimin e jashtëm ose organizimin e kohës ë lirë si dhe shpenzime gjatë një liralaje ose gjatë pushimeve, qiranë dhe magazinimin e mobileve, ushqime, procese gjyqësore, kompensime dhe dëmshpërblime.

7 Shkallët e ekzekutimit të vendimeve

7.1 Përcaktime të përgjithshme

Si shkallë ekzekutimi vendimi, te personat e rritur të burgosur mund të urdhërohet qëndrimi individual si një ndarje e pandërprerë nga personat e tjerë të burgosur. Qëndrimi individual në arrest mund të urdhërohet me fillimin e dënimit dhe për fillimin e ekzekutimit për një kohëzgjatje prej maksimumi një javë nga ana e autoritetit për ekzekutimin e vendimit penal.

Pas kalimit të kohës së qëndrimit individual në arrest personi i burgosur strehohet normalisht në një ambient normal për vuajtjen e dënimit.

7.2 Përcaktime të veçanta në arrestin hetimor dhe të sigurisë

Shkallët e ekzekutimit të vendimit vlejné për personat e burgosur të rritur në arrest hetimor dhe sigurie

- arrest hetimor individual,
- dhe vuajtje normale e dënimit.

Pas ardhjes personi i burgosur strehohet normalisht në një arrest individual. Ky arrest individual në fillimin e heqjes së lirisë shërben për sigurimin e qëllimit të heqjes së lirisë te të gjithë të burgosurit, për të sqaruar aspekte të rëndësishme për sigurinë dhe aftësinë e të burgosurit për të qëndruar në grup. Në koordinim me drejtuesit e procesit, drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale mund ta strehojnë të burgosurin në kushte normale për vuajtjen e dënimit.

Më së voni pas kalimit të 14 ditëve personi i burgosur kalon nga arresti individual në vuajtjen e dënimit në kushte normale, përveç rastit kur autoriteti që ka kryer burgosjen, me kërkesë të drejtuesit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, ose me nxitjen e vetë autoritetit që ka kryer burgosjen, urdhëron strehimin në arrest individual. Si autoriteti që ka kryer burgosjen, gjatë arrestit hetimor vlen prokuroria.

- Brenda afatit ligjor, drejtuesit e institucionit bazuar në nenin 35 pika 3 e ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale për të rinjtë nga arsyet e përmendura në nenin 35 pika 1 e ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale për të rinjtë kërkojnë te autoriteti që ka kryer burgosjen zgjatje të arrestit individual deri në maksimumi 6 muaj. Institucioni i ekzekutimit të vendimit kërkon transferimin mbrapa të një personi të burgosur nga vuajtja e dënimit në kushte normale në arrest individual pranë autoritetit që ka kryer burgosjen për të njëjtat arsye.
- Prokuroria urdhëron për garantimin e qëllimit të arrestit hetimor (nenin 224 ff. dhe 235 pika 1 e kodit të procedurës penale me nxitjen e vet strehimin në arrest individual (neni 108 pika 4 rregullores për ekzekutimin e vendimeve juridike) ose zgjatjen e tij pas përfundimit të maksimumi 14 ditëve.

7.2.1.1 Arresti individual

Në arrest individual personi i burgosur kalon kohën e punës, qetësisë dhe të lirë normalisht i ndarë nga të burgosurit e tjerë në institucion.

Personi i burgosur mund të qëndrojë minimumi një orë në ditë në oborrin ku kryhet shëtitja.

7.2.1.2 Vuajta e dënimit në kushte normale

Në rastin e vuajtjes së dënimit në kushte normale personi i burgosur e kalon kohën e tij të punës, qetësisë dhe të lirë me persona të tjerë të burgosur në institucion.

Personi i burgosur mund të qëndrojë minimumi tre orë në ditë jashtë qelisë.

7.2.1.3 Të burgosurit e rinj

Të burgosurit e rinj kalojnë çdo ditë të paktën tetë orë jashtë qelisë.

Ato posedojnë të drejtën që të qëndrojnë çdo ditë të paktën dy orë në ajër të pastër. Në fundjavë dhe në ditët zyrtare të festave, ora e dytë mund të zëvendësohet me një qëndrim në një ambient të përbashkët.

7.2.1.4 Përcaktimi i statusit aktual

Më së voni pas një kohe qëndrimi prej tre muajsh nga institucioni kryhet një përcaktim i statusit aktual për organizimin dhe zbatimin e vuajtjes së dënimit për personin e burgosur.

8 Rutina ditore, strehimi, ushqimi, higjiena trupore

Për strehimin e të gjithë personave të burgosur vlejnë rregulloret e ndarjes.

Drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale duke u koordinuar me autoritetet që kanë kryer burgosjen në raste të veçante mund të shmangen nga rregulloret e ndarjes, nëse ekzistojnë interesa mbizotëruese të personave në fjalë dhe kundër këtyre përcaktimeve nuk flet asgjë.

8.1 Rutina ditore

Rutina ditore përcaktohet nga drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Rutina ditore i bëhet me dije personit të burgosur.

8.2 Strehimi

Personit të burgosur i caktohet në mënyrë standarde një qeli me një ose shumë shtretër. Qelia në përputhje me udhëzimet e personelit të burgut rajonal duhet të mbahet në gjendje të rregullt dhe të pastrohet.

Personat që nuk e pinë duhanin nuk strehohen në një qeli me disa krevate, në të cilën pihet duhan.

8.3 Shëtitja

8.3.1 Përcaktime të përgjithshme

Personi i burgosur posedon të drejtën që çdo ditë të qëndrojë të paktën për një orë në mjedis të hapur (shëtitje). Momenti kohor i shëtitjes përcaktohet nga drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

8.3.2 Të burgosurit e rinj

Të burgosurit e rinj posedojnë të drejtën që çdo ditë të dalin të paktën për dy orë në ajër të pastër.

8.4 Ushqimi dhe kioska

Personi i burgosur ushqehet nga institucioni. Gjatë përgatitjes së planit të menysë merren parasysh informacione shkencore në lidhje me të ushqyerin. Ushqim të veçantë merr, ai i cili me rekomandim të mjekut ka nevojë për ushqim special. Kërkesat e veçanta në lidhje me ushqimin, të cilat rezultojnë nga përkatësia fetare ose nga një mënyrë të ushqyeri konsekuente vegjetariane, merren në konsideratë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Në kuadrin e mundësive financiare personale personi i burgosur mund të kryejë blerje shtesë përmes shërbimit të brendshëm të burgut rajonal në kuadrin e produkteve që shiten në kioskë. Procedurat e blerjes në kioskë rregullohen në përcaktime të veçanta të drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

8.5 Larja e rrobave dhe higjiena trupore

Personi i burgosur mban rrobat e veta. Rrobat duhet të lahen rregullisht nga personi i burgosur. Në raste të arsyetuara për sa i përket higjienës, drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale mund ti lajnë rrobat me shpenzimet e personit të burgosur.

Higjiena ditore trupore kryhet në qeli. Bërja e dushit, bazuar në rutinën ditore të drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale është e mundur.

Për arsye higjienike ose që lidhje me aromat, drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale mund ta detyrojnë një person të burgosur për zbatimin e detyrueshëm të higjienës trupore.

Aty ku ekziston mundësia, rrobat mund të lahen duke përfshirë çdo përgjegjësi nga personeli i burgut rajonal.

8.6 Pirja e duhanit

Pirja e duhanit normalisht është e ndaluar në të gjitha mjediset. Përfshirë bëjnë qelitë e banimit dhe oborret ku kryen shëtitjet.

Në kuadrin e mundësive tuaja financiare si duke respektuar detyrimet ligjore, personi i burgosur mund të blejë duhan përmes shërbimit të brendshëm të burgut rajonal. Procedurat e blerjes në kioskë rregullohen në përcaktime të veçanta të drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

8.7 Kafshët

Mbajtja e kafshëve është e ndaluar.

9 Mundësitë e kontaktit

9.1 Vizitat

9.1.1 Përcaktime të përgjithshme

Vizitat lejohen të paktën një orë në javë. Drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale mund të përcaktojnë rregulla të tjera në lidhje me vizitat, nëse koha e vizitës do të rritet. Gjatë vizitës lejohet dhënia e objekteve që janë konsideruar si të pranueshme nga institucioni dhe e parave të gatshme. (shihni fletët informuese për vizitat zyrtare dhe private).

Për arsye të sigurisë dhe rregullit në institucion vizita mund të varet nga fakti që vizitoret dhe vizitorët të kontrollohen për objekte jo të lejuara (shihni fletën informuese për vizitat private).

Personat, të cilët rrezikojnë sigurinë dhe rregullin e burgut rajonal ose shkelin rregulloret e vizitave, mund të përjashtohen nga vizitat nga ana e drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për maksimumi tre muaj, në rastin e përsëritjes përgjithmonë. Bashkëshortja/-i ose partnerja/-i, fëmijët, prindërit dhe motrat dhe vëllezërit nuk lejohen të përjashtohen përgjithmonë.

Për fëmijët dhe të rinjtë nën 18 vjeç vizita lejohet vetëm i shoqëruar (prindi, familjarë, përfaqësuesi ligjor). Vizitat zyrtare si dhe vizitat e mjekeve, mjekëve dhe nga avokatet dhe avokatët e regjistruar në regjistrin e avokatëve nuk llogariten si kontingjent vizitash (shihni fletën informuese për vizitat zyrtare).

9.1.2 Përcaktime të veçanta në arrestin hetimor dhe të sigurisë, masat detyruese të heqjes së lirisë të ligjit për të huajt

Në rastin e personave të burgosur që gjenden në arrest hetimor dhe sigurie miratimi i vizitave nga ana e drejtuesve të procesit në përputhje me kodin e procedurës penale / kodin e procedurës penale për të rinjtë është kusht. Ajo mund të parashikojë modalitete më të rrepta në lidhje me vizitat.

Për masat detyruese të heqjes së lirisë të ligjit të të huajve vlen fleta informuese „Vizita në arrestin administrativ sipas ligjit për të huajt“

9.2 Posta me letër

9.2.1 Përcaktime të përgjithshme

Personi i burgosur posedon të drejtën për të dërguar dhe marrë letra. Kufizimet janë të lejuara vetëm për shkak të ngarkesës së tepër për kontrollin e tyre. Në rastin e të burgosurve të rinj qarkullimi i letrave nuk kufizohet.

Posta private në dalje duhet të dorëzohet e mbyllur. Posta private që vjen hapet, kontrollohet për objekte të huaja dhe dorëzohet çdo ditë. Në rast dyshimi për keqpërdorim të qarkullimit të letrave mund të ndodhë që letrat të kontrollohen në përmbajtje si në dalje ashtu edhe në hyrje. Personi i burgosur orientohet në lidhje me letrat që nuk janë dërguar më tej.

Letrat me gjykatat, autoritetet, institucionet, klerikët, mjeket dhe mjekët, avokatet dhe avokatët, noteret dhe noterët si dhe përfaqësueset dhe përfaqësuesit ligjor personi i burgosur do ti dorëzojë të mbyllura, por të kontrolluara për objekte të ndaluara.

Dërgesat jo të lejuara të letrave ruhen, shkatërrohen ose i kthehen dërgueses ose dërguesit me shpenzimet e personit të burgosur, nga institucioni duke ja bërë me dije personit të burgosur.

9.2.2 Përcaktime të veçanta në arrestin hetimor dhe të sigurisë

Në rastin e personave që gjenden në arrest hetimor ose sigurie të gjitha kontrollet e letrave dhe të korrespondencave si dhe kufizimi ose ndalimi i qarkullimit të letrave kryhen vetëm nga drejtuesit të procesit, bazuar në kodin e procedurës penale / kodin e procedurës penale për të rinjtë.

9.3 Pakot, dhuratat, paratë e gatshme

9.3.1 Përcaktime të përgjithshme

Në favor të personit të burgosur mund të dorëzohen para të gatshme me vlerë të pakufizuar. Paratë e gatshme kalohen në llogarinë e lirë të personit të burgosur.

Dërgimi ose dorëzimi i produkteve në natyrë është e lejueshme dhe nuk lejohet të kalojë peshën prej tre kilogramësh në muaj. Në muajt e ditëlindjeve të personave të burgosur, për pashkë ose krishtlindje lejohen edhe përkatësisht tre kilogramë të tjera shtesë. Pakot dhe dhuratat, të cilat nuk janë të lejueshme për sa i përket llojit ose kufizimeve në lidhje me numrin dhe sasinë (shihni shifrën 4.2.2 Objektet), kthehen mbrapa. Pakot dhe dhuratat i nënshtrohen një kontrolli për sa i përket përmbajtjes. Në rastin e një refuzimi të një pakoje nga institucioni personi i burgosur informohet. Në rastin e objekteve të ndaluara vendosin drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale nëse ato do të ruhen në institucion ose do të shkatërrohen. Objektet e tjera, personi i burgosur me shpenzimet e tij mund ti magazinojë, jashtë institucionit ose t'i kthejë dërgueses ose dërguesit.

E rezervuar mbetet konfiskimi i objekteve në përputhje me nenin 263 të kodit të procedurës penale.

Në çdo rast të dorëzimit të mallit duhet që personi i cili dorëzon mallin të paraqesë një dokument zyrtar identifikimi.

9.3.2 Përcaktime të veçanta në arrestin hetimor dhe të sigurisë

Në rastin e personave të burgosur në arrest hetimor ose sigurisë kontrolli i letrave të dërguara kryhet nga drejtuesit të procesit në përputhje me kodin e procedurës penale / kodin e procedurës penale për të rinjtë. Në rastin e dërgimit të pakove, me porosi të drejtuesve të procesit, kontrolli i përmbajtjes kryhet nga institucioni. Drejtuesit e institucionit mund të parashikojnë kufizime të gjera të objekteve të lejuara.

9.4 Gazeta, revista, libra

Personi i burgosur mund të abonojë publikime me shpenzimet e tij. Lodhja e abonimeve nga palë të treta është e lejuar. Publikimet me përmbajtje relevante penale (sidomos raciste, pornografike ose që adhurojnë dhunën), të cilat rrezikojnë sigurinë dhe rregullin ose janë në kundërshtim me qëllimin e vuajtjes së dënimit, janë të ndaluara.

Personi i burgosur mund të marrë borxh libra nga biblioteka e brendshme. Rregullat për marrjen borxh rregullohen nga përcaktimet e veçanta të bibliotekës të drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

9.5 Mjetet dhe pajisjet e komunikimit elektronik

9.5.1 Përcaktime të përgjithshme

Personit të burgosur, burgu rajonal i vendos në dispozicion falas një radio dhe/ose kundrejt një tarife qiraje një televizor.

Përdorimi i pajisjeve të tjera elektronike mund të lejohet në rastin individual nga institucioni dhe mund të vendoset në dispozicion. Për përdorimin mund të kërkohej pagesa e një tarife.

Këto pajisjes elektronike mund të kontrollohen nga punonjësit e institucionit.

Përdorimi i mjeteve dhe pajisjeve private të komunikimit elektronik është i ndaluar.

9.5.2 Përcaktime të veçanta të masave detyruese të heqjes së lirisë në ligjin e të huajve

Për personat e burgosur kundrejt të cilëve aplikohet masa detyruese e heqjes së lirisë ligjit për të huajt, pajisjet elektronike normalisht vendosen në dispozicion në kuadrin e mundësive të institucionit. Për përdorimin mund të kërkohej pagesa e një tarife.

Pajisjet elektronike mund të kontrollohen si dhe kufizohen dhe ndalohen, sapo ekziston frika e keqpërdorimit ose rrezikimit të sigurisë dhe rregullit, ose nëse përdorimi është në kundërshtim me qëllimin e vuajtjes së dënimit.

Drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale mund të lejojnë përdorimin e pajisjeve elektronike private, për sa kohë nga pajisja nuk mund të bëhen regjistrime të figurës dhe tonit.

9.5.3 Përcaktime të veçanta në arrestin hetimor dhe të sigurisë

Për personat e burgosur në arrest hetimor ose sigurie, nga ana e drejtuesve të procesit mund të bllokohet aksesimi te mediat.

9.6 Telefonia

9.6.1 Përcaktime të përgjithshme

Personat e burgosur mund të përdorin telefonin në kuadrin e mundësive të institucionit. Telefonia mund të kufizohet sidomos në kohë, për ti mundësuar të gjithë personave të burgosur akses në të njëjtën masë.

Shpenzimet për përdorimin e telefonit i mbulon personi i burgosur.

Mesazhet telefonike hyrëse transmetohen vetëm në raste emergjence dhe pa lidhje me procesin.

9.6.2 Përcaktime të veçanta të masave detyruese të heqjes së lirisë në ligjin e të huajve

Personat e burgosur në masa detyruese për heqjen e lirisë bazuar në ligjin e të huajve kanë parimisht jashtë kohëve të përfshirjes, në kuadrin e mundësive të institucionit, akses të lirë te telefonia.

9.6.3 Përcaktime të veçanta në arrestin hetimor dhe të sigurisë

Personat e burgosur në arrest hetimor ose sigurie normalisht nuk lejohen të telefonojnë në mjediset e institucionit. Për telefoninë janë përgjegjës drejtuesit e procesit bazuar në kodin e procedurës penale / kodin e procedurës penale për të rinjtë. Bisedat telefonike hyrëse nuk transferohen.

10 Kujdesi social dhe mjekësor

10.1 Kujdesi social

Në kuadrin e kujdesit të vazhdueshëm, personat e burgosur kanë në dispozicion për kujdesin e tyre social përveç organeve zyrtare shërbimet e korrigjuese dhe zbatuese të kantonit të Bernë.

10.2 Kujdesi mjekësor

10.2.1 Përcaktime të përgjithshme

Në rastin e personave që kanë ardhur së fundmi, kur ato hyjnë në institucion kryhet një bisedë mjekësore hyrëse.

Kujdesi shëndetësor i personit të burgosur kryhet nga shërbimi shëndetësor i brendshëm i burgjeve rajonal dhe/ose nga një mjeke e specializuar ose mjek i specializuar. Nuk ekziston përzgjedhja e mjekut sipas dëshirës. Vlen principi i ekuivalencës në sensin e emergjencës dhe kujdesit bazë mjekësor.

Nëse nevojitet një trajtim mjekësor stacionar, normalisht kryhet përshkrimi në stacionin e monitorimit në Inselspital Bernë (BEWA).

10.2.2 Përcaktime të veçanta të masave detyruese të heqjes së lirisë në ligjin e të huajve

Nëse nevojitet një trajtim mjekësor stacionar, e vendos autoriteti që ka kryer burgosjen, nëse do të kryhet dërgimi në BEWA, në një spital ose klinikë.

11 Kujdesi shpirtëror dhe kujdesi tjetër fetar

11.1 Kujdesi fetar

Personi i burgosur mund të marrë përkujdesje nga klerike dhe klerikë të kishave të vendit në përputhje me rutinën ditore të drejtuesve të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Vizitat e klerikeve dhe klerikëve të kishave të vendit nuk llogariten te kontingjenti i vizitorëve.

Personat e burgosur pa përkatësi të një kishe të vendit kanë gjithashtu të drejtën e kujdesit nga klerike dhe klerikë të kishave të vendit.

11.2 Kujdesi tjetër fetar

11.2.1 Përcaktime të përgjithshme

Vizitat nga përfaqësuese dhe përfaqësues të bashkësive të tjera fetare mund të lejohen, për sa kohë ato nuk mund të përjashtohen për arsye të sigurisë dhe rregullit. Drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale vendosin rast pas rasti, nëse mund të zhvillohen evente ose kujdesë të tjera fetare si vizita zyrtare ose private.

11.2.2 Përcaktime të veçanta në arrestin hetimor dhe të sigurisë

Përfaqësuesve dhe përfaqësuesve të bashkësive të tjera fetare ju nevojitet një miratim i vizitës nga drejtuesit përgjegjës të procesit.

12 Puna

12.1 Puna

12.1.1 Përcaktime të përgjithshme

Personat e burgosur që vuajnë dënimin me heqje lirie ose një masë penale me heqje lirie janë të detyruar, që të kryejnë punët që i caktohen atyre.

12.1.2 Përcaktime të veçanta në arrestin hetimor dhe të sigurisë

Personat e burgosur në arrest hetimor ose sigurie nuk kanë të drejtën e punës ose punësimit. Nëse vendi i punës i pranuar vullnetarisht gjendet jashtë qelisë, nevojitet si kusht paraprak miratimi i drejtuesve të procesit në përputhje me kodin e procedurës penale.

Drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale i cakton punën sipas mundësive personave që janë identifikuar që kanë dëshirë të punojnë.

Të rinjtë e burgosur mund të punësohen bazuar në kërkesën e tyre me miratimin e drejtuesve të procesit, nëse kushtet e institucionit e lejojnë një gjë të tillë.

12.1.3 Përcaktime të veçanta të masave detyruese të heqjes së lirisë në ligjin e të huajve

Personi i burgosur në një masë detyruese për heqjen e lirisë bazuar në ligjin për të huajt nuk është i detyruar të punojë.

Nëse heqja e lirisë bazuar në ligjin për të huajt zgjat më shumë se dy muaj, personit të burgosur i ofrohet një punë e përshtatshme.

12.2 Shpërblimi i punës

Personi i burgosur merre një shpërblim që varet nga puna e kryer prej tij dhe që është përshtatur me rrethanat. Shpërblimi për punën e kryer kalohet në llogarinë e qëllimshme dhe të lirë. Për personat e burgosur, të cilët transferohen nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale vlejnë përcaktimet në përputhje me planin e ekzekutimit të vendimit të institucionit të mëparshëm.

Nëse një personi të burgosur nuk mund ti ofrohet një punë për shkak të mundësive të munguara të punësimit, atëherë ai posedon të drejtën e një shpërblimi të reduktuar për punën. Të drejtën për shpërblimin e reduktuar të punës personi ka edhe në rast sëmundje, aksidenti ose paaftësisë në punë jo për fajin e tij.

E drejta për shpërblim pune nuk ekziston në rastin e refuzimit të punës, arrestit, vizitave private, shmangies, paaftësisë për punë për fajin e personit, ditët e festave zyrtare dhe në rastin e liridaljes ose pushimeve.

12.2.1 Përcaktime të veçanta në arrestin hetimor dhe të sigurisë

Personat e burgosur në arrest hetimor ose sigurie nuk posedojnë të drejtën e punës, punësimit dhe në këtë mënyrë nuk posedojnë as të drejtën për një shpërblim të reduktuar puna kur mungojnë mundësitë e punësimit.

Në rastin e personave të burgosur në arrest hetimor dhe sigurie shpërblimi i punës kalohet në llogarinë e lirë. Drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale mund të caktojnë një vlerë minimale, e cila i kalohet llogarisë së qëllimshme.

12.2.2 Përcaktime të veçanta të masave detyruese të heqjes së lirisë në ligjin e të huajve

Nëse një personi të burgosur bazuar në një masë detyruese për heqjen e lirisë bazuar në ligjin e të huajve nuk mund ti ofrohet një vend pune pas dy muajsh, ai merr një dëmshpërblim të barasvlershëm. Shpërblimi për punën e kryer kalohet në llogarinë e lirë.

13 Kontrollet dhe ekzaminimet

13.1 Kontrolli fizik

Drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale mund të kryejë një kontroll fizik të një personi të burgosur nga ana e personelit të të njëjtës gjini si dhe të kontrollojë pasurinë personale të lëvizshme dhe banesën e personit të burgosur.

Te personat e burgosur, të cilët dyshohen se fshehin objekte të ndaluara mbi ose në brendësi të trupit të tyre, sidomos në vrima të trupit që nuk shihen nga jashtë, ato mund të urdhërojnë një kontroll fizik intim nga ana e një mjekeje ose mjeku.

13.2 Kontrollet dhe marrja e kampioneve

Drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, në rast dyshimi për lëndë narkotike ose përdorim të alkoolit mund të urdhërojnë marrjen e kampioneve të urinës, gjakut, analiza të flokëve dhe kontrole të ngjashme nga ana e personelit. Ato mund të kryejnë gjithashtu kontrole të rregullta në periudha të ndryshme kohore.

13.3 Kontrolli i qelive dhe i pasurive të lëvizshme

Në çdo moment, në prani ose jo të personit të burgosur mund të kryhet një kontroll i qelive dhe i pasurive të lëvizshme. Mbi kontrollin e qelive dhe të pasurive të lëvizshme nga ana e personelit të burgut rajonal përpilohet një procesverbal.

13.4 Të rinjtë

Kryerja e kontroleve dhe ekzaminimeve në rastin e të rinjve të burgosur orientohet në nenin 13 dhe nenin 14 të ligjit për masat e kufizimit të lirisë për të rinjtë.

14 Masat disiplinore

14.1 Shkeljet disiplinore

14.1.1 Të burgosurit e rritur

Shkeljet e ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale, rregullores për ekzekutimin e vendimeve juridike, rregullores së brendshme si dhe e rregulloreve të drejtuesve ose të personelit të institucionit mund të dënohen si shkelje disiplinore, për sa kohë ato rrezikojnë bashkëjetesën në burgun rajonal.

Si shkelje disiplinore vlejnë sidomos:

- Shmangiet ose veprimet përgatitore për këtë gjë,
- refuzimi i punës dhe prishja e regjimit të punës,
- ndërhyrjet e kundërligjshme në vlerat e huaja pasurore,
- Kundërshtimi i personelit ose i drejtuesve të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale,
- Ofendimet, kërcënimet dhe sulmet kundrejt integritetit fizik ose seksual të personelit ose drejtuesve të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, të bashkë-burgosurve dhe personave të tjerë,
- kontaktet e ndaluara me të bashkë-burgosurit dhe persona të tjerë,
- shkelja e të drejtës së pushimit, liridaljes ose vizitës,

- Futja dhe nxjerrja, organizimi, ndërmjetësimi, prodhimi, posedimi dhe tregtia me objekte të ndaluara si armë ose objekte të ngjashme me armët ose të shkresave dhe parave kesh duke anashkaluar kontrollet ose objektet e tjera të deklaruara si të ndaluara nga ana e drejtuesve të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale,
- Futja dhe nxjerrja, organizimi, prodhimi, posedimi, konsumi dhe tregtia me alkool dhe lëndë narkotike ose lëndë të tjera me veprim të ngjashëm si dhe abuzimi me medikamentet,
- përdorimi abuziv i pajisjeve për komunikimin elektronik, i pajisjeve argëtuese elektronike, i harduerëve dhe softuerëve elektronik si dhe i mediave elektronike të ruajtjes,
- shpërndarja ose anashkalimi i kontrolleve ose falsifikimi i rezultateve të kontrolleve,
- ose shqetësime të tjera të rutinës së përditshme.

Përprjekja, nxitja dhe ndihmesa për kryerja e shkeljeve disiplinore gjithashtu mund të sanksionohet. Ndjekja penale mbetet e rezervuar.

14.1.2 Të burgosurit e rinj

Shkeljet e ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale, rregullores për ekzekutimin e vendimeve juridike, rregullores së brendshme si dhe e rregulloreve të drejtuesve ose të personelit të institucionit mund të dënohen si shkelje disiplinore, për sa kohë ato rrezikojnë bashkëjetesën në burgun rajonal.

Si shkelje disiplinore vlejnë:

- dhuna fizike, seksuale ose verbale kundrejt punonjësve dhe punonjësve, të rinjve të tjerë ose personave të tretë që ndodhen në institucion,
- tregtia me alkool dhe lëndë narkotike, posedimi i tyre dhe konsumi si dhe abuzimi me medikamente,
- Posedimi i objekteve të ndaluara,
- ndërhyrjet e kundërligjshme në vlerat e huaja pasurore,
- Shqetësimi i procesit të punës, të shkollës ose të banimit,
- përdorimi abuziv i pajisjeve për komunikimin elektronik, i pajisjeve argëtuese elektronike, i harduerëve dhe softuerëve elektronik si dhe i mediave elektronike të ruajtjes,
- Arratisja, shmangia ose veprimet përgatitore për këto,
- keqpërdorimi i pushimeve.

Përprjekja, nxitja ose ndihmesa mundet gjithashtu që të sanksionohen. Ndjekja penale mbetet e rezervuar.

14.2 Veprimet disiplinore

14.2.1 Të burgosurit e rritur

Veprimet disiplinore janë:

- paralajmërimi me shkrim,
- në rastin e ekzistencës së një varësie objektive me shkeljen disiplinore heqja e përkohshme ose kufizimi i:
 1. aktiviteteve në kohën e lirë deri në dy muaj,
 2. kontakteve me jashtë deri në dy muaj, ndërkohë që komunikimi me autoritetet, përfaqësueset ligjor, përfaqësuesit ligjor, kleriket dhe klerikët mbetet i rezervuar,
 3. përdorimi i parave deri në dy muaj,
- gjobë deri në 200 franga,
- arresti në qelinë vetjake ose një qeli bosh ose një qeli sigurie të krijuar për këtë gjë deri në maksimumi 14 ditë.

Sanksionet disiplinore mund të lidhen më njëri tjetrin. Përfshihen:

- lidhja me paralajmërimin me shkrim,
- urdhërimi në të njëjtën kohë i arrestimit dhe gjobës.

14.2.2 Të burgosurit e rinj

Veprimet disiplinore janë:

- paralajmërimi me shkrim,
- kufizimi i pjesëmarrjes në evente në kohën e lirë deri në një muaj,
- heqja ose kufizimi i të drejtës së vizitave ose të pushimeve deri në dy muaj,
- heqja ose kufizimi i posedimit të pajisjeve për komunikimin elektronik, të pajisjeve elektronike argëtuese, të harduerëve elektronik, të memorieve me softuerë dhe të mediave ruajtëse deri në dy muaj,
- mbyllja në qeli deri në pesë ditë,
- mbyllja e lehtë deri në 14 ditë,
- mbyllja e rëndë deri në 7 ditë.

Vizita e pjesëtarëve të familjes lejohet të kufizohet, nëse shkelja disiplinore lidhet ngushtë me një vizitë.

Sanksionet disiplinore mund të lidhen me njëri tjetrin. Përfshihet paralajmërimi me shkrim.

14.2.3 Ekzekutimi me kusht dhe përfundimi para kohe

Ekzekutimi i sanksioneve disiplinore mund të shtyhet plotësisht ose pjesërisht duke aplikuar një kohë prove prej deri në gjashtë muaj.

Ekzekutimi me kusht revokohet, nëse personi i burgosur bëhet fajtor në një shkelje tjetër disiplinore gjatë kohës së provës dhe prandaj duhet që dispiplinohet.

Arresti mund të shkurtohet, nëse qëllimi i disiplinimit është arritur para kohe.

15 Masa të veçanta sigurie

15.1.1 Të burgosurit e rritur

Nëse në rastin e një personi të burgosur ekziston në masë të madhe rreziku i shmangies ose rreziku i ushtrimit të dhunës kundrejt palëve të treta, vetes së vet ose sendeve, drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale mund të urdhërojnë masa të veçanta sigurie.

Si masa të veçanta sigurie merren sidomos në konsideratë:

- mbyllja në qelinë vetjake ose në një qeli bosh ose në një qeli sigurie të krijuar për këtë për maksimumi 14 ditë,
- tërheqja e objekteve të institucionit ose të konsumit ose të veshjeve, për të cilat ekziston frika se ato mund të keqpërdoren,
- ndërrimi i qelisë,
- fiksimi për mbrojtjen e personit të burgosur.

Autoriteti që ka kryer burgosjen mund të urdhërojë strehimin në një departament me siguri të rritur bazuar në arsyet sipas pikës 1 ose në arrest individual bazuar në arsyet sipas kodit penal deri në gjashtë muaj. I rezervuar mbetet transferimi në një institucion tjetër.

Një masë e veçantë sigurie lejohet të zgjasë vetëm për aq kohë, që ekziston një arsye detyruese.

15.1.2 Të burgosurit e rinj

Nëse në rastin e një të riu ekziston në masë të rritur rreziku i shmangies ose rreziku i ushtrimit të dhunës kundrejt palëve të treta, vetes ose sendeve si dhe rreziku i një shqetësimi të rëndë të procesit të

institucionit, atëherë drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale mund të urdhërojnë masa të veçanta sigurie.

Si masa të veçanta sigurie vlejné:

- heqja e objekteve, që ekziston frika se ato mund të keqpërdoren,
- ndarja nga të rinjtë e tjerë,
- heqja e të drejtës së qëndrimit në mjediset e përbashkëta,
- kufizimi i kontaktit me botën e jashtme,
- strehimi në një dhomë ose në një qeli të siguruar veçanërisht.

15.2 Urdhër

Drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale lëshojnë një sanksion disiplinor dhe masën e veçantë të sigurisë me anën e urdhrit. Për sanksione në rastin e shkeljeve kundrejt drejtuesve të institucionit eprori i qendrës së AJV lëshon një sanksion disiplinor.

Subjekti sqarohet personeli që është direkt i pranishëm i institucionit dhe raportohet me shkrim.

Drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale vlerësojnë objektin dhe emërtojnë shkeljen disiplinore. Më pas drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale i japin personit të burgosur para lëshimit të urdhrit disiplinor mundësinë që të deklarohet në lidhje me akuzat (dëgjesa ligjore). Pas vlerësimit të subjektit të raportuar dhe të deklarimit të personit të burgosur drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale lëshojnë nëse është e nevojshme një urdhër disiplinor, në të cilin ato caktojnë sanksionin disiplinor si pasojë ligjore.

Edhe pas urdhërimit të një mase të veçanta sigurie që duhet të zbatohet menjëherë, shkruhet subjekti dhe vlerësohet menjëherë nga drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Pas akordimit të dëgjësës ligjore bëhet shpallja e urdhrit të arsyetuar duke bërë me dije edhe sqarimi mbi të drejtën e kundërshtimit.

Urdhri disiplinor dhe urdhërimi i masave të veçanta të sigurisë i bëhet me dije me një arsyetim të shkurtër dhe me këshillën për mundësinë e ankimit si dhe i bëhet me dije autoritetit përgjegjës që ka kryer burgosjen.

15.3 Mjetet ligjore

15.3.1 Përcaktime të përgjithshme

Kundër urdhrit disiplinor personi i burgosur mund të ankohet brenda 3 ditëve nga bërja me dije pranë drejtorisë së policisë dhe ushtrisë të kantonit të Bernë.

Në rastin e ankesave kundër urdhrave mbi masat e veçanta të sigurisë, afati i ankimit është 30 ditë.

Ankimimi duhet të përpilohet në gjermanisht ose frëngjisht (gjuhët zyrtare) dhe duhet të përmbajë një kërkesë dhe një arsyetim si dhe nënshkrimin e personit të burgosur. Urdhri që kundërshtohet dhe provat e kuptueshme duhet ti bashkëlidhen. Marrja e ankimit konfirmohet nga personeli i institucionit me datë, kohë dhe nënshkrim. Ankimi i duhet drejtuar autoritetit të ekzekutimit të vendimeve penale, Gerechtigkeitsgasse 36, Kutia postare, 3001 Bernë.

Ankimimi kundër urdhërave në rastin e masave të veçanta sigurie dhe sanksioneve disiplinore nuk ka veprim shtytës, përveç rastit kur drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ose shërbimi i ankimit i drejtorisë së policisë dhe ushtrisë e lëshon atë për arsye të rëndësishme për shkak zyrtar ose me kërkesë të personit të burgosur në fjalë.

15.3.2 Të burgosurit e rinj

Në rastin e urdhrave mbi masat kufizuese të lirisë sipas ligjit për masat e kufizimit të lirisë për të rinjtë afati është 10 ditë nga hapja. Ankimi mund të bëhet me shkrim nga e reja ose i riu në fjalë ose nga përfaqësuesi ligjore.

16 Dalja dhe lirimi

16.1 Dalja

Gjatë daljes nga një institucion i ekzekutimit të vendimeve penale personi i burgosur merr një përmbledhje të llogarive të tij.

Kthimi i objekteve të inventarizuara (pasuritë e lëvizshme) gjatë largimit nga burgu rajonal shënohet në inventar dhe konfirmohet me shkrim nga personi i burgosur. Nëse nënshkrimi i personit të burgosur nuk mund të merret, kthimi duhet të konfirmohet nga përfaqësuesja ose përfaqësuesi i personit të burgosur ose nga personi zyrtar, i cili merr përsipër personin e burgosur gjatë daljes së tij.

16.2 Lirimi

16.2.1 Përcaktime të përgjithshme

Lirimi kryhet mbështetur në urdhrin e lirimimit me shkrim të autoritetit që ka bërë burgosjen ose nga drejtuesit e procesit bazuar në kodin e procedurës penale / kodin e procedurës penale për të rinjtë.

Gjatë lirimimit vendosin drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale në koordinim me autoritetin që ka kryer burgosjen, nëse vlerat pasurore do të drejtohen plotësisht ose pjesërisht personit të liruar ose qendrës së përshtatshme. Gjatë lirimimit dorëzohen pasuritë e lëvizshme në përputhje me listën e pasurive të lëvizshme kundrejt konfirmimit. Në lidhje me vlerat pasurore të personit të burgosur përpilohet një përmbledhëse. Një vlerë që mund të ketë mbetur i dorëzohet personit të burgosur, përfaqësueses / përfaqësuesit të tij ose personit zyrtar që e shoqëron ato, kundrejt një konfirmimi.

Pagesat me para të gatshme kryhet kundrejt një fature.

16.2.2 Përcaktime të veçanta të masave detyruese të heqjes së lirisë në ligjin e të huajve

Autoriteti që ka kryer burgosjen mund të vendosë, që të gjitha ose një pjesë e vlerave pasurore e personave në fjalë, të cilat i tejkalojnë 1000 frangat, të përdoren për pagesën e shpenzimeve të kthimit.

17 Përgjegjësia

Personi i burgosur është plotësisht përgjegjës për dëme, të cilat ai i ka kryer me dashje ose për shkak të neglizhencës së rëndë të mjediset dhe mobiliet. Për mbulimin e dëmeve mund të preken vlerat pasurore në llogarinë e lirë ose të qëllimshme të personit të burgosur. Padia penale kundër personit të burgosur për shkak të dëmit material mbetet e rezervuar.

18 Dispozita përfundimtare

18.1 Rregulla plotësuese

Drejtuesit e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, bazuar në këtë rregullore të brendshme mund të lëshojnë rregulla plotësuese.

18.2 Hyrja në fuqi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje të brendshme me datë 1 Mars 2019 shfuqizohet rregullorja e brendshme e burgjeve rajonale e datës 1 Qershor 2016.

Bernë, me 1 Mars 2019

Autoriteti i ekzekutimit të vendimeve penale



Romilda Stämpfli
Drejtoreshë e autoritetit

Shtojcë

Konkretizimi i objekteve të ndaluara (jo përfundimtar):

Ushqime

- Pije, lëngje, shurup, mjaltë, reçel
- Ushqime që prishen, fruta dhe perime
- Vezë, mish, qumësht ose produkte qumështi (gjalpë, krem, kos etj.)
- Fast-Food (Pica, Döner-Kebab, Hamburger, Poulet etj.)
- Brumëra që piqen në shitje të lirë (bukë, simite, ëmbëlsira etj.)
- Arra, çamçakëz
- Ushqime të gatuar ose të pjekura vetë
- Ushqime të cilat para se të konsumohen duhet që të ngrohen/gatohen ende (supa të çastit etj.)

Material paketimi

- Konserva (kanaçe, kavanoza, tubete etj.)
- Kanaçe spraj (të gjitha llojet e enëve nën presion)
- Paketime prej/ose me llamarinë (Pringles, mbajtëse duhani etj.)
- Paketime prej xhami (shishe etj.)

Armë ose vegla të ngjashme me armët

- Vegla, qirinj, çakmakë dhe shkrepëse

Pajisje elektronike

- Telefona celular
- Smartwatch-e, byzylykë
- Televizorë
- Radio, impiante muzikorë, pajisje për transmetimi
- Aparate fotografik,
- Pajisje video
- Konsola loje
- Kompjuter dhe tabletë me pajisjet përkatëse periferike dhe aksesorë
- Cigare elektrike

Lëndë narkotike

- Droga, medikamente dhe erëza
- Pije alkoolike
- Mjete që pihen si duhan CBD

Të tjera

- Taxcard
- Të gjitha llojet e luleve dhe bimëve
- Mediat pornografike, seksiste, raciste ose që adhurojnë dhunën
- Të gjitha objektet, të cilat paraqesin një përmbajtje relevante penale